

Akte nënligjore
të Akademisë Austriake të Shkencave
miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Akademisë më 13 Tetor 2017
Vjenë 2017

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Copyright 2016 nga
Akademia Austriake e Shkencave
Vienë

Ky përkthim është vetëm për qëllime informimi dhe nuk do të jetë ligjërish i detyrueshëm. Në të gjitha rastet, versioni gjerman do të jetë ligjërish i detyrueshëm

Aktet nënligjore të Akademisë Austriake të Shkencave

<i>I. Anëtarët</i>	5
<i>A. Llojet e anëtarëve</i>	5
<i>B. Zgjedhja e anëtarëve</i>	5
<i>C. Të drejtat e votimit të anëtarëve dhe pozita ligjore</i>	6
<i>D. Ndryshime lidhur me anëtarësinë</i>	8
<i>E. Përfundimi i anëtarësisë</i>	8
<i>II. Takimet</i>	9
<i>A. Dispozitat procedurale për mbajtjen e Asamblesë së Përgjithshme, Takimeve të Degëve dhe Takimeve të Akademisë së të Rinjve</i>	9
<i>B. Asambleja e Përgjithshme</i>	11
<i>C. Takimet e degëve</i>	13
<i>D. Takimet e Akademisë së të Rinjve</i>	13
<i>E. Sesioni Ceremonial</i>	14
<i>III. Komisioni Drejtues</i>	14
<i>A. Anëtarët e Komitetit Drejtues</i>	14
<i>B. Zgjedhja e Komisionit Drejtues</i>	14
<i>C. Fushat e punës së Komitetit Drejtues dhe anëtarëve të tij, Përfaqësimi</i>	16
<i>IV. Administrata qendrore</i>	20
<i>V. Këshilli i Akademisë</i>	23
<i>A. Anëtarët, zgjedhja dhe shkarkimi</i>	23
<i>B. Urdhri i brendshëm i Këshillit të Akademisë</i>	24
<i>C. Pjesëmarrja në mbledhjet e mbajtura nga Këshilli i Akademisë dhe komitetet e tij</i>	25
<i>D. Thirrja e takimeve të Këshillit të Akademisë</i>	25
<i>E. Detyrat dhe të drejtat e Këshillit të Akademisë</i>	25
<i>F. Raportimi në Asamblenë e Përgjithshme</i>	28
<i>G. Përfaqësimi i Akademisë</i>	28
<i>H. Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit të Akademisë H. dhe detyra e kujdesit</i>	29
<i>VI. Komisionet Shkencore</i>	29
<i>VII. Institutet</i>	30
<i>A. Dispozita të përgjithshme</i>	30
<i>B. Marrëveshjet e synuara</i>	32
<i>C. Konferenca e drejtorëve të instituteve</i>	32
<i>VIII. Organet këshillimore shkencore</i>	33
<i>A. Bordi i Kërkimit Shkencor</i>	33
<i>B. Bordet këshillimore shkencore</i>	33
<i>C. Organe të tjera këshillimore shkencore</i>	34
<i>IX. Stafi</i>	34
<i>X. Grupi i punës për mosdiskriminim</i>	35
<i>XI. Dispozita të përkohshme</i>	36

AKTET NËNLIGJORE

Akademia Austriake e Shkencave është një subjekt publik që gëzon mbrojtje të veçantë nga qeveria federale.

Statusi i saj ligjor bazohet në vendimin suprem të Ferdinandit I më 14 maj 1847, i cili u transferua ligjërisht në bazë të aktit federal të datës 14 tetor 1921 (Ligji Federal i Gazetës 1921/394) i ndryshuar më 30 dhjetor 2003 (Ligji Federal Gazeta 130/2003), dhe në Statutin e Akademisë Austriake të Shkencave të dekretuar nga Presidenti Federal. Detyra e Akademisë është të promovojë shkencën në të gjitha fushat, veçanërisht në fushën e kërkimit bazë.

I. Anëtarët

A. Llojet e anëtarëve

Neni 1 (1) Sipas nenit 6 të statutit, anëtarët e Akademisë Austriake të Shkencave (këtej e tutje do të referohet si "Akademia") janë anëtarë të plotë, anëtarë nderi, anëtarë korrespondentë në Austri, anëtarë korrespondentë jashtë vendit ose anëtarë të Akademisë së të Rinjve. Numri maksimal i anëtarësisë për secilën kategori është përcaktuar në paragrafin. 1 të Nenit 6 të statutit. Data e ndërprerjes për kufirin e moshës së përcaktuar në paragrafin 2 i asaj pjese është 31 dhjetori i vitit kalendarik që i paraprin ditës së zgjedhjeve.

(2) Kur bëhet zgjedhja e anëtarëve të plotë dhe korrespondentë si dhe anëtarëve të Akademisë së të Rinjve, duhet të sigurohet që ata të përmbushin në një mënyrë të shkëlqyer standardet e larta në lidhje me personalitetin, punën shkencore dhe reputacionin në komunitetin shkencor në kuptimin e detyrave të Akademisë, që ata të angazhohen për të përmbushur detyrimet e tyre dhe, së fundi, që disiplinat shkencore të përfaqësohen në një mënyrë të balancuar dhe të përshtatshme. Për më tepër, duhet të merret parasysh një raport i balancuar i grave dhe burrave.

(3) Anëtarët e nderit të dy degëve zgjidhen për shkak të arritjeve të jashtëzakonshme shkencore, për Akademinë në tërësi për shkak të shërbimeve ndaj shkencës, shtetit ose shoqërisë.

B. Zgjedhja e anëtarëve

Neni 2 (1) Anëtarët e rregullt dhe korrespondentë, si dhe anëtarët e nderit, zgjidhen një herë në vit, në mbledhjen zgjedhore, para seancës ceremoniale. Duhet të ftohen për këtë vetëm anëtarët e rregullt. Procesi zgjedhor udhëhiqet nga rregullat me shkrim për zgjedhjet e Akademisë Austriake të Shkencave.

(2) Anëtarët e Akademisë së të Rinjve zgjidhen një herë në vit në mbledhjen zgjedhore të Akademisë së të Rinjve. Procesi zgjedhor administrohet sipas dispozitave të Nenit 3. Anëtarët e zgjedhur të Akademisë së të Rinjve konfirmohen në mbledhjen zgjedhore sipas Nenit 2 paragrafi 1.

Neni 3 (1) Anëtarët e Akademisë së të Rinjve zgjidhen një herë për një kohëzgjatje prej tetë vjetësh. Zgjedhja si anëtar korrespondent ose i, rregullt në një nga degët e Akademisë përfundon anëtarësimin e tyre në Akademinë e të Rinjve.

(2) Zgjedhjet mbahen në përputhje me rregullat e zgjedhjeve, të cilat Akademia e të Rinjve i përcakton për vete, duke marrë parasysh kriteret e Nenit 1 paragrafi 2. Këto rregulla zgjedhore duhet të përcillen në Komitetin Drejtues për konfirmim.

(3) Në kohën e zgjedhjes, një anëtar i Akademisë së të Rinjve duhet të ketë përfunduar studimet e doktoraturës jo më pak se dy dhe jo më shumë se dhjetë vjet më parë. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve duhet të jenë të moshës më të vogël se 40 vjet në kohën e zgjedhjes së tyre. Ky kufizim moshe mund të ndryshojë, duke marrë parasysh kohën e kujdesit për fëmijët. Detajet e mëtejshme përcaktohen nga Akademia e të Rinjve në rregullat e veta zgjedhore.

(4) Kandidatët e zgjedhur duhet të konfirmohen individualisht nga takimi zgjedhor sipas përcaktimit të Neni 2 paragrafi 1. Për këtë, dokumentet që justifikojnë emërimin duhet të sigurohen nga Akademia e të Rinjve. Një shumicë absolute e votave të vlefshme të hedhura është e nevojshme për konfirmim.

Neni 4 (1) Pas konfirmimit të votimit dhe nëse kërkohet, anëtarëve të sapozgjedhur u kërkohet të deklarojnë pranimin e tyre të votës dhe vullnetin e tyre për të përmbushur detyrimet që vijnë me anëtarësinë (Neni 8).

(2) Ministri korrespondent federal duhet të informohet për emrat e kandidatëve të zgjedhur.

(3) Pozita ligjore e një kandidati të zgjedhur si anëtar konfirmohet pas marrjes së deklaramit të pranimit përcaktuar në paragrafin 1.

C. Të drejtat e anëtarëve lidhur me votimin dhe pozita ligjore

Neni 5 (1) Anëtarët e rregullt kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në të gjitha Asamblenë e Përgjithshme, Takimet Zgjedhore (Neni 2 paragrafi 1) dhe të gjitha takimet e degëve të tyre.

(2) Tetë anëtarë korrespondentë në Austri nga çdo degë kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme dhe në mbledhjet e tyre të degës. Ata përzgjidhen sipas përcaktimit në Nenin 6.

(3) 16 Anëtarë të Akademisë së të Rinjve kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme. Ata përzgjidhen sipas përcaktimeve në Nenin 7. Këta anëtarë të Akademisë së të Rinjve gjithashtu kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhjet e mbajtura nga dega me të cilën lidhet fusha e specializuar e anëtarit të Akademisë së të Rinjve, që është fusha e ekspertizës për zgjedhjen respektive të anëtarit në Akademinë e të Rinjve.

(4) Të gjithë anëtarët e Akademisë së të Rinjve kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhjet e Akademisë së të Rinjve.

Neni 6 (1) Anëtarët korrespondentë në Austri që kanë të drejtë vote votohen çdo pesë vjet. Personat që kanë mbushur 65 vjeç nuk mund të zgjidhen më. Afati i mandatit është 1 vlefshëm për pesë vite kalendarike.

(2) Të paktën tre muaj para përfundimit të mandatit, anëtarët korrespondentë në Austri nga çdo degë caktojnë dymbëdhjetë kandidatë duke përzgjedhur deri në dymbëdhjetë anëtarë nga lista e plotë e kandidatëve që janë anëtarë korrespondentë në Austri.

(3) Zgjedhjet gjithashtu mund të kryhen duke përdorur mjete elektronike. Dy kryetarët e degës janë përgjegjës për ekzekutimin dhe vlerësimin e zgjedhjeve, dhe mbështeten në këtë nga Administrata Qendrore.

(4) Propozimet renditen sipas numrit të votave; tetë anëtarët korrespondentë në Austri nga secila degë që marrin më shumë vota zgjidhen fitues, në varësi të pranimit të tyre. Nëse dy anëtarë korrespondentë në Austri që marrin numrin e njëjtë të votave renditen në vendin e tetë në ndarjen e tyre, zgjidhet kandidati më i ri. Anëtarët mund të rizgjidhen një herë.

(5) Nëse ndonjë nga anëtarët korrespondentë të zgjedhur në Austri që kanë të drejtën e votës (paragrafi 4) nuk janë përkohësisht në gjendje të marrin pjesë në mbledhje ose të votojnë, anëtarët e radhitur në katër vendet më poshtë mund t'i zëvendësojnë ata, në varësi të pranimit të tyre. Nëse dy anëtarë korrespondentë në Austri renditen në vendin e fundit me numër të njëjtë të votash, zgjidhet kandidati më i ri.

(6) Nëse një anëtar i zgjedhur sipas kësaj dispozite jep dorëheqjen gjatë periudhës së përcaktuar në paragrafi 1, anëtari i renditur në zgjedhje poshtë vijës, sipas paragrafi 4, merr përsipër pjesën tjetër të mandatit. Nëse një anëtar i tillë nuk është i disponueshëm, pozicioni mbetet vakant deri në zgjedhjet e ardhshme.

(7) Rezultatet e zgjedhjeve, si dhe çdo eveniment sipas paragrafit 6, duhet t'i raportohen degës dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 7 (1) 16 anëtarët e Akademisë së të Rinjve, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë dhe votojnë në Asamblenë e Përgjithshme për një vit, zgjidhen çdo vit pas takimit zgjedhor sipas përcaktimit në Nenin 2 paragrafi 1, në kohë për Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme. Rezultati duhet t'i raportohet Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet Komisionit Drejtues.

(2) Përveç anëtarëve të Akademisë së të Rinjve të deleguar në Asamblenë e Përgjithshme, gjithsej tetë të tjerë zgjidhen për të zëvendësuar këta delegatë në rast se të parët nuk janë përkohësisht në gjendje të marrin pjesë ose të votojnë në mbledhje.

(3) Nëse një anëtar i Akademisë së të Rinjve i zgjedhur sipas kësaj dispozite jep dorëheqjen gjatë mandatit të tij / saj, duhet të zgjidhet një pasues në mbledhjen e ardhshme të Akademisë së të Rinjve.

Neni 8 (1) Duke pranuar zgjedhjen e tyre, të gjithë anëtarët angazhohen për avancimin e qëllimeve të Akademisë dhe për të marrë pjesë në kryerjen e detyrave të veta.

(2) Anëtarët kanë të drejtë të japin prezantime në aktivitetet e organizuara nga Akademia dhe të japin informacione për detyrat e tyre të lidhura me Akademinë dhe aktivitetet shkencore. Përgjegjës për rregullimin e prezantimeve është Kryetari i Degës (Neni 12 paragrafi 2).

(3) Anëtarët me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme gjithashtu kanë të drejtë të paraqesin kërkesa tek organet përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet që lidhen me kërkesat.

Neni 9 Anëtarët me të drejta votimi që banojnë jashtë qytetit në të cilën mbahet takimi do të rimbursohen për shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit, dhe po ashtu do të vepohet për të gjithë anëtarët që u është besuar përfaqësimi i Akademisë në ngjarje/evenimente ose në kryerjen e detyrave të Akademisë jashtë vendit të tyre të banimit. Niveli i shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit bazohet në udhëzimet e Akademisë për shpenzimet e udhëtimit.

D. Ndryshimi i anëtarësisë

Neni 10 (1) Nëse një anëtar i rregullt ose korrespondent në Austri transferon vendin e tij të përhershëm të qëndrimit jashtë vendit, ai / ajo hyn në radhët e anëtarëve korrespondentë jashtë vendit.

(2) Nëse një anëtar korrespondent jashtë vendit e zhvendos vendin e tij të përhershëm të qëndrimit në Austri, ai hyn në radhët e anëtarëve korrespondentë në Austri.

(3) Nëse një anëtar i mëparshëm i rregullt, i cili është bërë anëtar korrespondent jashtë vendit për shkak të transferimit jashtë shtetit, kthehet në Austri, ai / ajo hyn në radhët e anëtarëve të rregullt.

(4) Në të tre rastet, ndryshimi në llojin e anëtarësisë hyn në fuqi sapo të shpallet një pozicion në kategorinë anëtarë korrespondentë të Degës dhe Kryetari këshillon anëtarin e anëtarësisë së re me shkrim. Nëse anëtari në radhë tashmë ka mbushur 70 vjet, ndryshimi hyn në fuqi sapo Kryetari të këshillojë anëtarin e anëtarësisë së re me shkrim. Një raport duhet të dërgohet në degën respektive.

(5) Nëse një anëtar i Akademisë së të Rinjve zhvendos vendin e tij të përhershëm të qëndrimit jashtë vendit, anëtarësimi i tij në Akademinë e Rinjve pezullohet por kjo nuk rezulton në kufizimin ose ndërprerjen e afatit maksimal të anëtarësisë sipas Nenit 3 paragrafi 1. Ndryshimi (me një anëtar tjetër) bëhet efektiv pasi anëtari të jetë zhvendosur. Pozicioni i anëtarit të pezulluar mund të rimbushet.

(6) Nëse një anëtar i Akademisë së të Rinjve, anëtarësimi i të cilit është pezulluar, zhvendos vendin e tij të përhershëm të qëndrimit në Austri, ai hyn në radhët e anëtarëve të Akademisë së të Rinjve. Ndryshimi bëhet efektiv pasi shpallet një pozicion e Akademisë së të Rinjve dhe Kryetari ka këshilluar anëtarin e anëtarësisë së re me shkrim.

E. Përfundimi i anëtarësisë

Neni 11 (1) Anëtarësimi përfundon me kalimin e kohës (anëtarët e Akademisë së të Rinjve), vdekjen, dorëheqjen ose dënimin me burgim më shumë se një vit, të lëshuar nga një gjykatë austriake, për një ose më shumë veprime të dënueshme të kryera me paramendim. Nëse dënimi pezullohet sipas kushteve, anëtarësimi do të përfundojë sapo revokimi të hyjë në fuqi (Neni 53 Kodi Penal Austriak StGB). Kur dënimi jepet nga një gjykatë e huaj, do të zbatohet Neni 73, StGB në përputhje me rrethanat.

(2) Nëse një anëtar deklaron dorëheqjen e tij / saj, ndërprerja hyn në fuqi dhjetë ditë pas marrjes së njoftimit për dorëheqje. Njoftimi për dorëheqje duhet të bëhet me shkrim; data në të cilën është pranuar nga Komiteti Drejtues regjistrohet me shkrim.

(3) Nëse një anëtar vepron në një mënyrë që dëmton ose ka të ngjarë të dëmtojë Akademinë, institutet, organet ose reputacionin e saj, Asambleja e Përgjithshme, nëse dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të plotë sipas Neni 6 paragrafi 1 a të statutit janë të pranishëm, mund të vendosin ta përjashtojnë këtë anëtar, pas rekomandimit të një komisioni të angazhuar për të vlerësuar dhe diskutuar çështjen, dhe pas një seance me anëtarin korrespondent.

II. Takimet

A. Dispozitat procedurale për mbajtjen e Asambleve të Përgjithshme, takimet e degës dhe takimet e Akademisë së të Rinjve

Neni 12 (1) Anëtarët e Akademisë që kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhje mbledhen së paku gjashtë herë në vit në Asamblenë e Përgjithshme, Takimet e Degës dhe Takimet e Akademisë së të Rinjve (seancat e punës në përputhje me Nenin 17 paragrafi 1: Asambleja e Përgjithshme e zakonshme, takim i zakonshëm i degës, takimi i zakonshëm i Akademisë së të Rinjve). Para fillimit të një viti pune, Komisioni Drejtues (Nenet 23 e në vijim) krijon një kalendar takimesh për mbledhjet e përgjithshme dhe mbledhjet e degës, të cilat duhet t'i dërgohen çdo anëtar. Kryetari i Akademisë së të Rinjve bën të njëjtën gjë gjithashtu. Anëtarët që kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në mbledhjet dhe personat e përcaktuar në Nenin 18 paragrafi 2 - përderisa i përkasin njërive të Akademisë - janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet në të cilat ata thirren.

(2) Kryetari i Akademisë, Akademisë së të Rinjve dhe kryetarët e degëve (Nenet 31 paragrafi 1 a, 35 paragrafi 1, 21 paragrafi 2 b) janë përgjegjës respektivisht për thirrjen e Asambleve të Përgjithshme, takimeve të degës dhe mbledhjeve të Akademisë së të Rinjve. Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ai përfaqësohet nga Zëvendëskryetari në Asamblenë e Përgjithshme, nga anëtar i tjetër i degës përkatëse në Komisionin Drejtues për mbledhjet e degës dhe nga zëvendëskryetari në mbledhjet e Akademisë së të Rinjve. Përndryshe zbatohen rregullat e përfaqësimit në Nenin 36 në përputhje me rrethanat.

(3) Këshilli i Akademisë duhet të mbledhë Asamblenë e Përgjithshme nëse kjo është e nevojshme për të mirën e Akademisë (Neni 50, paragrafi 5).

(4) Nëse së paku një e treta e anëtarëve që e votojnë e kërkojnë këtë me shkrim tek kryetari, duke bashkëngjitur një axhendë të propozuar të arsyetuar, ose nëse kështu vendos Komiteti Drejtues, takimet duhet të mbahen brenda dy javësh pas pranimit të letrës nga kryetari ose brenda dy javësh nga vendimi i Komisionit Drejtues.

(5) Lajmërimi për një mbledhje dhe axhenda e planifikuar duhet t'u dërgohet anëtarëve pjesëmarrës dhe atyre që votojnë së paku 48 orë para takimit respektiv.

(6) Çdo anëtar me të drejtë vote ka të drejtë të paraqesë kërkesa të paktën dy javë para mbledhjeve (paragrafi 1). Këto duhet të formulohen dhe justifikohen në mënyrë të duhur dhe t'i dërgohen kryetarit, i cili i fut ato në rendin e ditës. Neni 13 paragrafi 2 nuk ndikohet nga ky përcaktim.

Neni 13 (1) Kryetari hap, udhëheq dhe mbyll mbledhjet; ai / ajo siguron mbajtjen e rregullt të fletëvotimeve të nevojshme. Rregullat e zëvendësimit në Nenin 12 paragrafi 2 zbatohen në përputhje me rrethanat.

(2) Nëse gjatë mbledhjes, anëtari me të drejtë vote kërkon që të shtohet një çështje e veçantë në rendin e ditës dhe kjo kërkesë të pranohet (Neni 15, paragrafi 1), çështja duhet të adresohet në të njëjtën mbledhje. Megjithatë, vendimet e marra për aktivitetet sipas Nenit 19 paragrafi 1a deri në e, j dhe l, Neni 20 paragrafi 2 a dhe b, dhe Neni 21 paragrafi 2 a deri në c dhe f, gjithmonë kërkojnë një ftesë dhe informacion paraprak për procedurat e menjëhershme sipas Nenit 12 paragrafëve 2 deri në 5.

(3) Gjatë mbledhjes, çdo anëtar me të drejtë vote është i lirë të kërkojë që të flasë për çështjen që diskutohet. Kryetari duhet t'i pranojë këto kërkesa sipas rendit në të cilin kanë ndodhur.

(4) Nëse një anëtar me të drejtë vote kërkon të komentojë procedurat e mbledhjes, siç përcaktohet në aktet nënligjore (kërkesa për të folur për aktet nënligjore), kjo e drejtë duhet të jepet menjëherë.

(5) Nëse pranohet kërkesa për përfundimin e diskutimeve (përfundimi i debateve) (Neni 15, paragrafi 1), merren parasysh vetëm kërkesat e parashtruara para kësaj kërkesë; pika e diskutimit duhet të votohet pas kësaj.

(6) Me pikat specifike të rendit të ditës, para ose gjatë takimit, mund të lidhen njoftime, përmbledhur shkurtimisht me shkrim, në lidhje me problemet e lidhura me një pikë të rendit të ditës ose në lidhje me listat dhe parashtrimet relevante për çështjet financiare dhe të bazuara në buxhet.

Neni 14 (1) Për vendimet dhe zgjedhjet që duhet të bëhen në Asamblenë e Përgjithshme dhe në mbledhjen zgjedhore sipas Nenit 2 paragrafi 1, duhet të jenë të pranishëm të paktën 40 anëtarë të plotë. Të paktën 20 anëtarë të plotë duhet të jenë të pranishëm për takimet e degës dhe së paku 20 anëtarë të Akademisë së të Rinjve duhet të jenë të pranishëm për takimet e Akademisë së të Rinjve dhe takimin zgjedhor sipas Nenit 2 paragrafi 2.

(2) Vendimet mund të bëhen në qarkullim elektronik, me kusht që informacioni i nevojshëm për vendimin t'i dërgohet të gjithë anëtarëve me të drejtë vote për vendimin të paktën tre ditë pune para çdo afati të vendimmarrjes. Në mënyrë që vendimi të konsiderohet i vlefshëm, duhet të hidhen të paktën 50 për qind e votave në dispozicion dhe është e nevojshme përmbushja e kërkesave të vendimmarrjes sipas përcaktimit në Nenin 8 të statutit. Ndalohet fletëvotim i fshehtë sipas paragrafit 5, pika 2: emrat dhe përmbajtja e votimit duhet të dokumentohen dhe t'i paraqiten për shikim, me kërkesën e tij / saj, çdo personi që ka të drejtë vote.

(3) Nuk lejohen rezoluta qarkulluese për planin e zhvillimit, marrëveshjet e performancës me ministrinë përgjegjëse federale, aktet nënligjore dhe statutin.

(4) Zgjedhjet mund të bëhen me anë të mjeteve elektronike, me kusht që të gjithë anëtarët që kanë të drejtë vote në zgjedhje të informohen në kohë. Në mënyrë që zgjedhjet të jenë të vlefshme duhet të merren të paktën 50 për qind e votave në dispozicion. Rregullat e zgjedhjeve duhet të sigurojnë që zgjedhjet elektronike të kryhen edhe në mënyrë të fshehtë, të lirë, të barabartë, në prani fizike dhe menjëherë.

(5) Votat duhet të hidhen në mënyrë të hapur. Ata mund të jenë sekret vetëm në rastin e zgjedhjeve, nëse kryetari e specifikon këtë ose nëse këtë e kërkon një anëtar me të drejtë vote dhe kjo mbështetet nga dy anëtarë të tjerë me të drejtë vote.

(6) E drejta e votës mund të ushtrohet vetëm personalisht.

(7) Secili anëtar me të drejtë vote ka të drejtë të paraqesë një votë të veçantë (Neni 16, paragrafi 2).

Neni 15 (1) Një shumicë absolute e votave të vlefshme është e nevojshme për pranimin e një kërkesë dhe vendimin për t'u konsideruar i vlefshëm (Neni 8 paragrafi 1 i statutit). Nëse votat janë të barabarta, Kreu (i Akademisë, Degës, Akademisë së të Rinjve) ka votën vendimtare. Abstenimi nuk lejohet.

(2) Rregullorja e veçantë për kërkesat e veçanta të votimit nuk ndikohet nga sa më sipër.

Neni 16 (1) Duhet të mbahet procesverbal për çdo mbledhje; shënimet duhet të përfshijnë emrat e anëtarëve të pranishëm, kërkesat dhe vendimet e marra në lidhje me pikat e rendit të ditës, si dhe çdo pakicë ose vota të veçanta. Duhet gjithashtu të përfshihen edhe përmbajtja e raporteve dhe dialogët relevante për vendimet.

(2) Votimi i veçantë duhet të shpallet gjatë mbledhjes dhe t'i dorëzohet kryesuesit brenda tri ditë pune, së bashku me një deklaratë të arsytimit. Nëse kryetari e konsideron përmbajtjen në përputhje me negociatat, shtohet në procesverbal; nëse jo, duhet të paraqitet në mbledhjen e ardhshme.

(3) Në procesverbal duhet t'i sigurohet qasje çdo anëtarit me të drejtë vote.

Neni 17 (1) Seancat e punës janë konfidenciale. Ata trajtojnë çështje administrative dhe shkencore të Akademisë (për Asamblenë të Përgjithshme), degës (për mbledhjet e degës) ose Akademisë së të Rinjve (për mbledhjet e Akademisë së të Rinjve), në të cilat duhet të diskutojnë dhe vendosin anëtarët me të drejtë vote (Nenet 19-21).

(2) Mund të mbahen gjithashtu takime publike, të cilat në veçanti përbëhen nga prezantime shkencore, njoftime dhe raporte.

Neni 18 (1) Akademia mund të thërrasë për këshillim përfaqësues specialistë për çështje shkencore.

(2) Kryetari mund të ftojë për të raportuar mbi aktivitetet e tyre edhe anëtarë të tjerë joakademikë, si drejtorët dhe staf nga institutet ose ndërmarrjet shkencore dhe tregtare të Akademisë, si dhe persona të tjerë që nuk i përkasin institucioneve të Akademisë.

(3) Në Asamblenë e Përgjithshme, në mbledhjet e degës dhe në mbledhjet e Akademisë së të Rinjve, duhet të raportohen proceset relevante dhe vendimet e marra nga Komiteti Drejtues,

Këshilli i Akademisë dhe Bordi i Kërkimit Shkencor, për aq sa ato ndikojnë në fushat e punës së Asamblesë së Përgjithshme, Takimet e Akademisë së të Rinjve (Nenet 19-21).

(4) Nëse, gjatë diskutimeve nuk paraqet kërkesë asnjë anëtar me të drejtë vote, kryesuesi duhet, nëse është e nevojshme, të paraqesë një kërkesë për të marrë vendim.

B. Asambleja e Përgjithshme

Neni 19 (1) Si organ këshillimor, mbikëqyrës dhe vendimmarrës i Akademisë, Asambleja e Përgjithshme ka këto prerogativa, përveçse kur nuk parashihet ndryshe me aktet nënligjore:

- a. Të vendosë për planin e zhvillimit të Akademisë, me kërkesë të Komitetit Drejtues;
- b. Të zgjedhë dhe shkarkojë anëtarët e Komisioni Drejtues;
- c. Të zgjedhë dhe shkarkojë anëtarët e Këshillit të Akademisë;
- d. Të zgjedhë dhe shkarkojë anëtarët e Bordit të Kërkimit Shkencor;
- e. Të themelojë dhe shpërndajë komisionet e Akademisë në tërësi, si dhe të zgjedhë dhe të shkarkojë anëtarët e komisioneve të tilla;
- f. T'i bëjë propozime Komisionit Drejtues në çështjet për të cilat ky i fundit është përgjegjës për vendimmarrje, në veçanti sugjerime për futjen e programeve të reja shkencore ose krijimin e instituteve të reja;
- G. Të marrë vendime për pozicionet që do të shpallen në zgjedhjen e anëtarëve të nderit në Akademi;
- h. Të miratojë llogaritë vjetore bazuar në raportin e Këshillit të Akademisë dhe të ratifikojë veprimet e palës përgjegjëse;
- i. Të japë çmime në emër të Akademisë në tërësi dhe thirrje për nominime për shpërblime. Këto detyra mund të transferohen tek një organ i autorizuar për të marrë këto vendime (komisioni i shpërblimeve ose një organ i ngjashëm);
- j. Të veprojë si arbitër në çështjet e Komitetit Drejtues në të cilat nuk është marrë pëlqimi i kërkuar i Këshillit të Akademisë;
- k. Të modifikojë statutin dhe aktet nënligjore të Akademisë;
- l. Të marrë vendime për rregullat e zgjedhjeve të Akademisë sipas Nenit 2 paragrafi 1.

(2) Asamblesë së Përgjithshme i jepet e drejta e vetos në çështjet në vijim për të cilat merren vendime nga Komiteti Drejtues. E drejta e vetos mund të ushtrohet me shumicën e dy të tretave të votave të vlefshme nëse janë të pranishëm të paktën gjysma e numrit të anëtarëve të plotë të deklaruar në Nenit 6 paragrafit 1 a të statutit, për:

- a. Marrëveshje të performancës me ministrinë federale përgjegjëse për çështjet e Akademisë;
- b. Vendimet për buxhetin e një periudhe të caktuar buxhetore, bazuar në vlerën totale buxhetore respektive të

1. degëve,
2. akademisë së të Rinjve,
3. akademisë në tërësi,
4. institucioneve që kryejnë kërkime,
5. administratës Qendrore,
6. shpenzimet e lidhura me shoqëritë,

plus çdo kosto për shkak të vendndodhjes;

- c. Parimet e promovimit të hulumtuesve të rinj.

(3) Dispozitat e Neni 55 zbatohen për komisionet shkencore.

(4) Pasi të jenë miratuar llogaritë (paragrafi 1 h), ndarja që tregon përdorimin e fondeve të siguruara nga qeveria federale duhet të dërgohet në Gjykatën e Auditimit të Austrisë.

(5) Kërkesat për ndryshimin e statutit dhe akteve nënligjore mund të parashtrohen nga çdo anëtar me të drejtë vote. Në Asamblenë e ardhshme të Përgjithshme, duhet të merret një rezolutë për të vendosur nëse kërkesa duhet të përfshihet në diskutime apo jo.

(6) Me një rezolutë të miratuar me shumicë prej katër të pestave të votave të vlefshme të hedhura në prani të së paku të dy të tretave të anëtarëve të rregullt të deklaruar në Nenin 6 paragrafi 1 a të statutit, Asambleja e Përgjithshme mund të devijojë nga dispozitat individuale të këtyre akteve nënligjore. Megjithatë, kjo nuk duhet të ndikojë në detyrat dhe të drejtat e Këshillit të Akademisë ose statutit të Akademisë.

(7) Komiteti Drejtues duhet të informojë gjerësisht Asamblenë e Përgjithshme të çështjeve të Akademisë. Kjo e drejtë për informacion ka të bëjë veçanërisht me vendimet dhe rekomandimet e bëra nga Këshilli i Akademisë dhe Bordi i Kërkimit Shkencor, si dhe çdo çështje në të cilën Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën e vetos ose të drejtën për të marrë një vendim.

(8) Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për t'u dëgjuar për çështje themelore që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë shkencore.

C. Takimet e Degës

Neni 20 (1) Çdo degë diskuton dhe vendos në mënyrë të pavarur çështjet administrative dhe shkencore që ndikojnë në të, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga këto akte nënligjore.

(2) Sfera e veprimtarisë së degës përfshin në veçanti çështjet e mëposhtme:

- a. Vetëm anëtarët e rregullt vendosin për shpalljen e pozicioneve për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë ose anëtarëve të nderit; vetëm anëtarët e rregullt vendosin për zgjerimin e disiplinave në sferën e veprimtarisë së degës, si dhe për të rekomanduar kandidatët sa i përket kualifikimeve të tyre të larta shkencore dhe ndoshta edhe në aspektin e disiplinës që ata përfaqësojnë; për të votuar në zgjedhje që kufizohen specifikisht për anëtarët e rregullt sipas rregullave zgjedhore të Akademisë;
- b. Krijimin dhe shpërndarjen e komisioneve të degës, si dhe zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të komisioneve të tilla;
- c. Propozimin e anëtarëve për Bordin e Kërkimit Shkencor;
- d. Bërjen e propozimeve për Komitetin Drejtues ose Asamblenë e Përgjithshme lidhur me çështjet që u janë caktuar këtyre organeve për vendimmarrje, në veçanti sugjerime për futjen e programeve të reja shkencore ose ngritjen e instituteve të reja;
- e. Shpërndarjen e shpërblimeve dhe çmimeve që mund të jepen vetëm nga dega. Këto detyra mund të transferohen tek një organ i autorizuar për të marrë këto vendime (komisioni i shpërblimeve ose organe të ngjashme);
- f. Vendimin për botimin e veprave shkencore dhe përfshirjen e eseve/studimeve në botimet e degës. Kjo çështje mund t'i caktohet një organi të autorizuar për të marrë vendime të tilla (komisioni i botimit).

(3) Për komisionet shkencore zbatohen dispozitat e Nenit 55 (paragrafi 2 b).

(4) Takimi i Degës ka të drejtën për t'u dëgjuar për çështjet themelore që lidhen me sigurimin e cilësisë.

D. Takimet e Akademisë së të Rinjve

Neni 21 (1) Përveçse kur parashihet ndryshe në këto akte nënligjore, Akademia e të Rinjve vepron dhe vendos në mënyrë të pavarur në çështjet shkencore dhe administrative që ndikojnë në të; ajo duhet të jetë e përfshirë sa më shumë që të jetë e mundur në detyrat shkencore të Akademisë dhe në axhendat publike.

(2) Në sferën e veprimtarisë së Akademisë së të Rinjve përfshihen në veçanti si më poshtë:

- a. Zgjedhja dhe shkarkimi i përfaqësuesve të Akademisë së të Rinjve që lejohen të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme;
- b. Zgjedhja dhe shkarkimi i një komiteti drejtues ("Bordi Drejtues") nga ata anëtarë që kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme. Bordi Drejtues emëron një

zëdhënës, si dhe një zëvendës zëdhënës, për të marrë funksionin e kryesuesit / zëvendëskryesuesit sipas Neneve 12 e në vijim;

c. Krijimi dhe shpërndarja e komisioneve të Akademisë së të Rinjve;

d. Propozimi i anëtarëve për Bordin e Kërkimit Shkencor;

e. Bërja e propozimeve për Komitetin Drejtues ose Asamblenë e Përgjithshme lidhur me çështjet që u janë caktuar këtyre organeve për vendimmarrje ose rekomandime, në veçanti sugjerime për futjen e programeve të reja shkencore ose instituteve të reja shkencore;

f. Shpërndarja e fondeve monetare të akorduara për Akademinë e të Rinjve si pjesë e marrëveshjes së performancës / buxhetit të përgjithshëm; duke llogaritur përdorimin e këtyre fondeve.

(3) Anëtarët e Akademisë së të Rinjve duhet, në konsultim me Komitetin Drejtues, të krijojnë mundësi për raportim të ndërsjellë. Komiteti Drejtues duhet t'u përcjellë autoriteteve të përcaktuar propozimet sipas paragrafit 2 d dhe e.

(4) Shkarkimi sipas paragrafit 2 a dhe b ndodh sipas Nenit 24 paragrafi 5.

(5) Akademia e të Rinjve paraqet rregulla të brendshme për ndjekjen e detyrave të saj dhe këto duhet t'i përcillen Komisionit Drejtues. Këto rregulla duhet të përcaktohen me shkrim dhe nuk duhet të jenë në kundërshtim me ndonjë dispozitë të akteve nënligjore.

(6) Për komisionet shkencore zbatohen dispozitat e Nenit 55 (paragrafi 2 c).

(7) Akademisë së të Rinjve i jepet e drejta për t'u dëgjuar për çështjet themelore që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë.

E. Seanca ceremoniale

Neni 22 (1) Çdo vit zhvillohet një seancë ceremoniale publike, në të cilën duhen ftuar të gjithë anëtarët, drejtorët e instituteve, stafi dhe figurat publike.

(2) në këtë seancë raportohen aktivitetet e Akademisë dhe paraqiten anëtarët e sapozgjedhur.

III. Komiteti Drejtues

A. Anëtarët e Komitetit Drejtues

Neni 23 (1) Komiteti Drejtues i Akademisë është një organ kolegjal i përbërë nga Kryetari, Nënkyetari dhe dy kryetarët e degëve.

(2) Kryetari dhe nënkryetari duhet të jenë pjesë e degëve të ndryshme, ashtu si edhe kryetarët e degëve.

B. Zgjedhja e Komitetit Drejtues

Neni 24 (1) Sipas paragrafëve të mëposhtëm, Komiteti Drejtues duhet të zgjidhet nga anëtarët me të drejta votimi (Neni 5 paragrafi 1 deri në 3) nga anëtarët e rregullt çdo pesë vjet në Asamblenë e Përgjithshme përpara Sesionit Ceremonial që mbahet para mbarimit të mandatit të Komitetit Drejtues. Asambleja e Përgjithshme mund të caktojë një komision zgjedhor për të përgatitur këtë proces zgjedhor.

(2) Anëtarët e Komitetit Drejtues zgjidhen me shumicën absolute të votave të hedhura. Anëtarët e Komitetit Drejtues mund të rizgjidhen një herë në të njëjtin post. Nëse në një proces zgjedhor fillestar, nuk arrihet shumica e kërkuar për zgjedhjen e kandidatit, kalohet në zgjedhjen e dytë; nëse kjo është gjithashtu e pasuksesshme, ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota mbahen deri në tre votime balotazhi. Nëse kjo ende nuk jep rezultat, takimi zgjedhor duhet të përfundojë dhe procesi i zgjedhjeve rifillon nga e para.

(3) Kryetari zgjidhet jo më vonë se në Asamblenë e Përgjithshme në mars të vitit në të cilin mbaron afati i Komitetit Drejtues. Kandidati i zgjedhur si Kryetar duhet menjëherë, por jo më vonë se një javë para Asamblesë së Përgjithshme në prill, të propozojë gjithsej tre persona si kandidatë për pozitat e mbetura të Komitetit Drejtues.

(4) Kandidatët e propozuar nga Kryetari duhet të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme në prill. Nëse Asambleja e Përgjithshme pengon kandidatin për t'u zgjedhur, realizohet një proces zgjedhor i ngjashëm me atë që përdoret për Kryetarin për pozicionin respektiv.

(5) Anëtarët e Komitetit Drejtues mund të shkarkohen me shumicë prej dy të tretave të votave të hedhura në prani të tre të katërtave të numrit të anëtarëve të plotë të deklaruar sipas përcaktimit në Nenin 6 paragrafi 1 a të statutit.

(6) Nëse drejtori ose zëvendësdrejtori i njërit prej instituteve të Akademisë zgjidhet si anëtar i Komisionit Drejtues dhe nëse ky person e pranon zgjedhjen e tij, roli i tij drejtues në institutin korrespondent pezullohet për kohëzgjatjen e anëtarësimit në Komitetit Drejtues.

Neni 25 (1) Nëse pozicioni i Kryetarit bëhet vakant para se të zgjidhet një pasardhës, ai zihet nga nënkryetari deri sa pasardhësi të marrë detyrën. Zgjedhjet për të plotësuar pozicionin duhet të mbahen në Asamblenë e Përgjithshme brenda gjashtë muajsh që nga momenti i mbetur vakant. Në këtë rast, Kryetari i sapozgjedhur ka të drejtë të propozojë tre anëtarë të rinj për pozitën e mbetura në Komitetin Drejtues, të cilët pastaj i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për zgjedhje në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme pas zgjedhjes së Kryetarit, sipas Nenit 24 paragrafëve 3 dhe 4. Me marrjen e mandatit të anëtarëve të sapozgjedhur të Komisioni Drejtues, përfundon mandati i anëtarëve të Komitetit Drejtues në detyrë.

(2) Nëse mbetet vakant pozicioni i kryetarit të degës, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një kryetar të ri të degës brenda gjashtë muajve që nga momenti i mbetur vakant. Derisa pasardhësi merr detyrën, detyrat administrative kryhen nga kryetari i degës tjetër. Kryetari i degës duhet të zgjidhet duke marrë parasysh të drejtën e peticionit të Kryetarit sipas Nenit 24 paragrafi 3.

(3) Në qoftë se pozita e nënkryetarit mbetet vakant, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një Nënkryetar të ri brenda gjashtë muajve që nga momenti i mbetur vakant. Deri në kohën kur zëvendëskryetari i ri merr detyrën, detyrat e tij kryhen nga Kryetari. Zëvendëskryetari duhet të zgjidhet duke marrë parasysh të drejtën e peticionit të Kryetarit sipas Nenit 24 paragrafi 3.

(4) Në rast se nënkryetarët apo zëvendëskryetari përcaktuar në paragrafët 1 deri në 3 nuk janë në gjendje të ndërmarrin këto detyra, atëherë, derisa zëvendësuesi të marrë zyrtarisht pozicionin e tij / saj, detyrat e tij / saj duhet të kryhen nga anëtari më i vjetër i rregullt nën 70 vjeç në degën në të cilën është bërë vakant pozicioni i anëtarit të Komitetit Drejtues. Ky anëtar merr përsipër të drejtat dhe detyrat e anëtarit vakant të Komitetit Drejtues duke deklaruar se ai / ajo pranon rolin e përfaqësuesit. Nëse anëtari i emëruar nuk mund të veprojë si përfaqësues, fuqia e përfaqësimit transferohet tek anëtari tjetër më i vjetër nën 70 vjeç (sipas zgjedhjeve) i cili është i përgatitur të veprojë si përfaqësues.

(5) Kohëzgjatja e mandatit të kryetarit zëvendësues ose anëtarit të ri të emëruar të Komitetit Drejtues sipas paragrafit 1, kryetarit të degës sipas paragrafit 2, nënkryetarit sipas paragrafit 3 ose zëvendësit sipas paragrafit 4, sipas rastit, kufizohet në kufirin e mandatit standard të Komitetit Drejtues.

Neni 26 (1) Komiteti Drejtues fillon mandatin e tij më 1 korrik pas zgjedhjeve. Nëse Presidenti Federal nuk ka dhënë konfirmimin e tij / saj sipas Nenit 3 të ligjit federal në lidhje me Akademinë e Shkencave, ai fillimisht kryen rolin e tij në mënyrë të përkohshme. Në rast se në vendet e lira si anëtarë të Komitetit Drejtues janë emëruar zëvendësuesit sipas Nenit 25, anëtarët e rinj marrin pozicionet e tyre në fillim të muajit pasardhës.

(2) Në kohën ndërmjet zgjedhjeve dhe marrjes në dorëzim të detyrës, kandidatëve të zgjedhur duhet t'u jepet mundësia për të marrë pjesë - pa votim – në të gjitha mbledhjet ku ka të drejtë të marrë pjesë Komiteti Drejtues.

C. Fushat e punës së Komitetit Drejtues dhe anëtarëve të tij, Përfaqësimi

Neni 27 Detyrat e Komitetit Drejtues ndahen në tri fusha, ku përgjegjësitë rregullohen më hollësisht në dispozitat e mëposhtme:

1. Çështjet që lidhen me Akademinë në tërësi,
2. Çështjet që lidhen me degët,
3. Çështjet që kanë të bëjnë me institucionin që kryen kërkim shkencor.

Neni 28 I gjithë Komiteti Drejtues është përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me Akademinë në tërësi. Çështjet që lidhen me degën janë përgjegjësi e kryetarit respektiv të degës. Kryetari dhe Zëvendës Kryetari kanë përgjegjësi të përbashkët për çështjet që kanë të bëjnë me institucionin që kryen kërkim shkencor.

Neni 29 (1) Komiteti Drejtues, si organi përgjegjës për çështjet e Akademisë, është organi ekzekutiv i Akademisë dhe është përgjegjës për

- a. Përbushjen e detyrave, si dhe të drejtat dhe detyrat e Akademisë;
- b. Ekzekutimin e vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme;
- c. Respektimin e bazave ligjore të Akademisë, posaçërisht statutit dhe këtyre akteve nënligjore;
- d. Informimin e Këshillit të Akademisë për të gjitha transaksionet e rëndësishme si dhe informimin e menjëhershëm të Këshillit të Akademisë për të gjitha ngjarjet e rëndësishme që kanë rëndësi materiale në vlerësimin e situatës dhe zhvillimit aktual të Akademisë;
- e. Agjendat administrative.

(2) Kur përmbushin detyrat e tyre, anëtarët e Komitetit Drejtues duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur në postet e tyre në çështjet shkencore dhe administrative dhe të marrin parasysh parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, përshtatshmërisë dhe ekonomisë.

(3) Me qëllim të përmbushjes së detyrave administrative, Komiteti Drejtues përdor Administratën Qendrore. Komiteti Drejtues është përgjegjës për përcaktimin më të detajuar të rolit dhe strukturës së Administratës Qendrore, duke marrë parasysh dispozitat e akteve nënligjore.

(4) Komiteti Drejtues është përgjegjës për vendosjen e sistemeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm (përfshirë ato për përputhshmërinë, parandalimin e korrupsionit dhe auditimin e brendshëm). Kjo përfshin sigurimin e burimeve të nevojshme, të cilat i lejojnë Këshillit të

Akademisë ose komitetit të auditimit të realizojnë auditimin e brendshëm sipas Neni 50 paragrafi 3a brenda një fushëveprimi të arsyeshëm.

(5) Komiteti Drejtues është veçanërisht përgjegjës për:

a. Marrjen e vendimeve për çështjet shkencore dhe administrative, si dhe përfundimin e transaksioneve ligjore, përderisa kjo detyrë nuk i është caktuar një organi tjetër;

b. përcaktimin e datave për takimet e Akademisë;

c. Përgatitjen e të gjitha çështjeve që duhet të adresohen nga Asambleja e Përgjithshme, duke formuluar rendin e ditës dhe kërkesat për të cilat duhet të vendosë Asambleja e Përgjithshme;

d. Hartimin e planit të zhvillimit për t'ia paraqitur Asamblesë së Përgjithshme (Neni 19 paragrafi 1a);

e. Përgatitjen e kërkesave që kanë të bëjnë me çështjet që kërkojnë pëlqimin e Këshillit të Akademisë (Neni 50 paragrafi 6), përderisa kjo nuk bie nën përgjegjësinë e degëve apo institucionit që kryen kërkim shkencor;

f. Marrëveshjet përmbyllëse të performancës me ministrinë përgjegjëse federale, bazuar në planin e zhvillimit të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme (Neni 19 paragrafi 1 a);

G. Hartimin e buxhetit dhe shpërndarjen e buxhetit në të gjitha fushat e Akademisë;

h. Krijimin, marrjen, riemërimin dhe shpërndarjen e ndërmarrjeve tregtare që i përkasin Akademisë; duke përbushur të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Akademisë në këto kompani;

i. Përbushjen e të gjitha të drejtave dhe detyrave të Akademisë në institucionet e drejtuara në mënyrë të pavarur;

j. Përcaktimin dhe modifikimin e shpërndarjes së funksioneve (Neni 34);

l. Përfundimin e marrëveshjeve kolektive dhe marrëveshjeve operacionale;

m. Proceset dhe kriteret për promovimin e hulumtuesve të rinj;

n. Emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve për Administratën Qendrore;

o. Marrëveshje përmbyllëse për bashkëpunimin shkencor dhe shkëmbimin e shkencëtarëve me institucionet shkencore jashtë vendit edhe me kërkesë të degës kompetente;

p. Kontraktimin e ekspertit të auditimit të zgjedhur nga Këshilli i Akademisë për të audituar pasqyrën e llogarive;

q. Dorëzimin e pyetjeve sipas Neni 13 paragrafi 3 të statutit të Bordit të Kërkimit Shkencor;

r. Emërimin e anëtarëve të komitetit të ndarjes së programeve të granteve me propozimin e degëve dhe Akademisë së të Rinjve;

s. Komunikimin shkencor dhe punën për marrëdhëniet me publikun;

t. Bërjen e propozimeve për Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me dhënien e çmimeve dhe shpërblimeve zyrtare.

(6) Në rastet kur nuk është marrë pëlqimi i Këshillit të Akademisë sipas Nenit 50 paragrafi 6, Komiteti Drejtues mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme (Neni 19 paragrafi 1 j), i cili vendos përfundimisht.

(7) Në raste urgjente, d.m.th. nëse Akademia rrezikohet nga dëmtimi i pashmangshëm, dhe Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli i Akademisë nuk mund të marrë vendimin e kërkuar brenda një afati të caktuar ose nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të ushtrojë të drejtën e vetos, të vendosë dhe të informojë Asamblenë e Përgjithshme në mbledhjen e saj të ardhshme.

(8) Në çështjet ku Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën e vetos (Neni 19 paragrafi 2), Asamblesë së Përgjithshme duhet t'i jepet mundësia për të diskutuar dhe vendosur për çdo veto para se të merren vendimet.

Neni 30 (1) Komiteti Drejtues është në gjendje të marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me Akademinë në tërësi, me kusht që së paku tre anëtarë të jenë të pranishëm.

(2) Në mënyrë që të miratohet një rezolutë kërkohet një shumicë absolute e anëtarëve të pranishëm.

(3) Në rast se vota në Komitetin Drejtues është e ndarë në mënyrë të barabartë, për të marrë një vendim, thirret dhe i akordohet e drejta për të votuar Kryetarit që e ka mbajtur atë detyrë para Kryetarit në detyrë. Nëse ky ish-kryetar nuk është i disponueshëm, atëherë është thirrur ish-zëvendëskryetari dhe ka të drejtën e votës. Nëse ky i fundit nuk është i disponueshëm, atëherë ish-Kryetari nga periudha paraardhëse e mëparshme e zyrës, ose, nëse nuk është i disponueshëm, thirret ish-zëvendëskryetari i periudhës paraardhëse.

(4) Me kusht që asnjë anëtar i Komitetit Drejtues mos ta kundërshtojë, një vendim mund të miratohet në qarkullim; në këtë rast kërkohet unanimitet.

(5) Rezolutat duhet të regjistrohen me shkrim në procesverbal të nënshkruar.

Neni 31 (1) Kryetarët e degëve kanë përgjegjësi të vetme brenda degës të tyre për:

a. Kryesimin e takimeve të degës;

b. Ekzekutimin e vendimeve të degës respektive;

c. Marrëveshjet përfundimtare të synuara me njësitë organizative të caktuara për to;

d. Përgatitjen e aplikimeve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me degën respektive, të cilat kërkojnë miratimin e Këshillit të Akademisë (Neni 50 paragrafi 6) ose Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Kryetari i degës së bashku me anëtarin tjetër të Komitetit Drejtues nga ajo dege është përgjegjës për marrjen e vendimeve brenda degës të tij / saj në çështjet e ndërlidhjes. Transaksionet juridike ekzekutohen sipas Nenit 37 paragrafi 1.

Neni 32 Kryetari dhe Zëvendëskryetari kanë përgjegjësi të përbashkët për institucionin që kryen kërkime, në veçanti:

a. Marrjen e vendimeve për çështjet shkencore dhe administrative, si dhe lidhjen e transaksioneve ligjore;

b. Marrëveshjet përfundimtare të synuara me njësitë organizative të caktuara për to;

c. Krijimin, marrjen, ristrukturimin, riemërimin dhe shpërndarjen e instituteve; marrjen e vendimeve lidhur me formën ligjore të instituteve;

d. Ballafaqimin me çështjet që lindin në lidhje me punësimin, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këto akte nënligjore, në veçanti realizimin e kontratave të përhershme të punës;

e. Përgatitjen e aplikimeve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me institucionin kërkimor që kërkojnë miratimin e Këshillit të Akademisë (Neni 50 paragrafi 6) ose Asamblesë së Përgjithshme;

f. Emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të institutit dhe zëvendësit të tij sipas kritereve të sigurimit të cilësisë (Neni 13 paragrafi 3 b të statutit, Neni 29 paragrafi 5 k, së bashku me Nenin 50 paragrafi 7 (c) të këtyre akteve nënligjore).

Neni 33 (1) Në çështjet që kanë të bëjnë me degët (Neni 31 paragrafi 2) ose me institucionin kërkimor (Neni 32), vendimet mund të merren nëse janë të pranishëm të dy anëtarët e kryesuesit përgjegjës. Nëse dy anëtarët e Komitetit Drejtues nuk mund të arrijnë dakordësi, atëherë i gjithë Komiteti Drejtues merr vendimin sipas Nenit 30 paragrafi 1 deri 3.

(2) Me kusht që asnjë anëtar i Komitetit Drejtues të mos kundërshtojë, një rezolutë mund të miratohet në qarkullim.

(3) Rezolutat duhet të regjistrohen me shkrim në procesverbalin e nënshkruar.

Neni 34 (1) Komiteti Drejtues shpërndan funksionet e tij në mënyrë të tillë që detyra specifike që bien në tre sferat e veprimtarisë së tij mund t'u caktohen anëtarëve individualë të Komitetit Drejtues. Vendimi për shpërndarjen e funksioneve duhet të bëhet në mënyrë unanime; përgjegjësia e përgjithshme e Komitetit Drejtues nuk ndikohet nga shpërndarja e funksioneve të tij.

(2) Bazuar në shpërndarjen e funksioneve të caktuara për ta si pjesë e kësaj dispozite, anëtarët e Komitetit Drejtues janë mbikëqyrësit e personelit të caktuar për ta për të përmbushur detyrat e tyre.

(3) Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Akademisë dhe Këshilli i Punëve duhet të njoftohen/këshillohen për vendimet që ndikojnë në shpërndarjen e funksioneve.

Neni 35 (1) Kryetari udhëheq Komitetin Drejtues dhe Asamblenë e Përgjithshme. Kryetari siguron bashkëpunim të besueshëm në mes të Akademisë në tërësi, degëve dhe institucioneve që kryejnë kërkim brenda Akademisë. Ai / ajo përfaqëson Akademinë në marrëdhëniet me jashtë. Ai / ajo është gjithashtu përgjegjës për paraqitjen e rishikimeve dhe mendimeve të ekspertëve në emër të Akademisë dhe Komisionit Drejtues.

(2) Kryetari duhet të jetë mbikëqyrës suprem i të gjithë personave që punojnë në Akademi dhe të gjitha çështjet që dalin në Akademi. Si pjesë e të drejtës mbikëqyrëse të tij, ai / ajo është i autorizuar të mbikëqyrë përmbushjen e duhur të veprimtarisë së Akademisë, për të siguruar që personat dhe njësitë respektive të përmbushin detyrimet e tyre, të korrigjojnë çdo problem të identifikuar dhe të parandalojnë çdo problem të parashikuar.

(3) Në raste urgjente, d.m.th. nëse Akademia është në rrezik të dëmit të pashmangshëm dhe Komiteti Drejtues nuk mund të marrë vendimet e kërkuara brenda një kohe të caktuar, Kryetari - ose, nëse ai / ajo është përkohësisht i padisponueshëm, Nënkryetari - duhet të vendosë, madje edhe në rastet kur vetëm Komiteti Drejtues ka të drejtë të marrë vendime. Komiteti Drejtues duhet të jetë i verifikueshëm për vendimin.

(4) Njoftimet e dërguara në Komitetin Drejtues konsiderohen se janë pranuar nga ky i fundit sapo ato të jenë pranuar nga Kryetari.

Neni 36 (1) Nënkryetari zëvendëson Kryetarin dhe e ndihmon të kryejë detyrat e tij / saj. Nëse është e nevojshme, nënkryetari ka të drejtë për të gjitha kompetencat e dhëna Kryetarit në bazë të këtyre akteve nënligjore gjatë periudhës së përfaqësimit.

(2) Kryetari zëvendëson nënkryetarin në të gjitha detyrat që i janë caktuar atij në këto aktet nënligjore (Neni 34).

(3) Dy kryetarët e degës zëvendësojnë njëri-tjetrin në ato detyra që u caktohen atyre nga këto aktet nënligjore (Neni 34) ose në çdo përgjegjësi që ndikon në degën respektive.

(4) Në ato çështje të përshkruara në Nenet 31 paragrafi 1 dhe 32, një anëtar i Komitetit Drejtues i cili është përkohësisht i padisponueshëm, përfaqësohet nga anëtari tjetër i Komitetit Drejtues nga e njëjta degë. Nëse ky i fundit nuk është i disponueshëm, atëherë, në rast emergjence, do të zbatohen rregulloret e deklaruara në Nenin 35 paragrafi 3. Në ato çështje të përshkruara në Nenin 31 paragrafi 2, një kryetar i degës i cili përkohësisht është i padisponueshëm përfaqësohet nga kryetari i degës tjetër. Në rast se njëra apo tjetra nuk është e disponueshme, Kryetari

përfaqësohet nga nënkryetari dhe anasjelltas. Gjithmonë duhet të jetë i pranishëm një anëtar i Komitetit Drejtues nga dega përkatëse.

Neni 37 (1) Akademia përfaqësohet në mënyrë të detyrueshme dhe bashkërisht nga Kryetari dhe Nënkryetari. Në çështjet e degës, anëtarët e Komitetit Drejtues që i përkasin degës respektive gjithashtu mund të përfaqësojnë bashkërisht Akademinë.

(2) Kryetari dhe Nënkryetari garantojnë që të jenë në fuqi rregullat e përfaqësimit në rast se një anëtar i Komitetit Drejtues nuk është në dispozicion. Këta duhet të sigurojnë zbatimin e parimit të mbikëqyrjes me katër sy, dhe mund të sigurojnë lëshimin e autorizimit të përfaqësimit kur veprojnë si përfaqësues.

(3) Në rastet e përmendura në Nenin 35 paragrafi 3, anëtar i Komisionit Drejtues të autorizuar ka fuqinë e vetme të përfaqësimit.

(4) Në çështjet që kanë të bëjnë me institutet, caktohet për t'u përfaqësuar drejtori respektiv, ose nëse nuk është i disponueshëm, zëvendësdrejtori, duke marrë parasysh Nenin 57.

(5) Drejtuesit e instituteve dhe njësive të administratës mund të ngarkohen me detyra përfaqësimi në lidhje me Akademinë në bazë të vendimeve të Komitetit Drejtues. Në këtë rast, duhet të merret parasysh parimi i katër syve.

IV. Administrata qendrore

